

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe nenit 124 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/15), duke vepruar sipas propozimit për shpalljen si të pavlefshme të një aktvendimi, të dorëzuar nga Drejtoria për Zonat Zhvillimore Industriale Teknologjike, në mbledhjen e mbajtur më datë 06.09.2023, e solli këtë

AKTVENDIM

1.Propozimi Pa. nr.. 10-73 i datës 07.08.2023 (nr. 13-735/6 i datës 04.08.2023) i Drejtorisë për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale për shpalljen si të pavlefshëm të Aktvendimit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës Pa. nr.. 10-73 i datës 26.05.2023, PRANOHET.

2.Aktvendimi i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës Pa. nr. 10-73 i datës 26.05.2023, SHPALLET I PAVLËFSHËM, PËR SHKAK SE ZBATIMI I TIJ NUK ËSHTË I MUNDSHËM.

Arsyetim

Drejtoria për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale më datë 07.08.2023 ka dorëzuar shkresën nr. 13-735/6 (numri ynë protokollar 10-73 i datës 07.08.2023) me propozim deri te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: KMK) për shpalljen si të pavlefshëm të Aktvendimit të KMK-së Pa.nr. 10-73 i datës 26.05.2023.

Në shkresën e saj, Drejtoria për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale thekson se në lidhje me Aktvendimin e KMK-së Pa. nr. 10-73 i datës 26.05.2023, për ndarjen e ndihmës rajonale të planifikuar për Shoqërinë Aksionare për Prodhimin e Pajisjeve të Frenimit VABTEK MZT SHA Shkup, njofton KMK-në se deri në datën e shkresës me propozimin për shpalljen e Aktvendimit të KMK-së Pa. nr. 10-73 i datës 26.05.2023 si të pavlefshëm, Marrëveshja për ndarjen e ndihmës shtetërore nuk ishte nënshkruar.

Gjithashtu, në shkresën e Drejtorisë për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale, theksohet se nuk ekziston mundësi për zbatimin e Aktvendimit.

Për këto arsye, më 07.08.2023, Drejtoria për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale ka dorëzuar propozimin që KMK të shpallë si të pavlefshëm Aktvendimin e saj Pa.nr. 10-73 i datës 26.05.2023.

Pas shqyrtimit të propozimit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga Drejtoria për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale, KMK konstaton se:

KMK me Aktvendimin Pa.nr. 10-73 i datës 26.05.2023 kishte konstatuar se masat e përfshira në Njoftimin për ndarjen e ndihmës së planifikuar dhe informacionet shtesë për formularin për ndihmë rajonale paraqesin ndihmë shtetërore si ndihmë individuale rajonale në përputhje me nenin 4 paragrafi (1) pika 2 dhe pika 11 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10), ndërsa ndarja e saj lejohet vetëm nëse, përveç investimit të ri të planifikuar në ZZHTI Shkup 2, kompania do ta ruajë investimin ekzistues dhe objektin prodhues, së bashku me të gjithë të punësuarit në të njëjtin nivel si para

fillimit të investimit të ri të planifikuar, për një periudhë kohore që përputhet me periudhën e qëndrueshmërisë së investimit të ri në ZZHTI Shkup 2.

Në propozimin e Drejtorisë për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale, thuhet se Marrëveshja për ndarjen e ndihmës shtetërore për VABTEK MZT SHA Shkup nuk është nënshkruar fare dhe gjithashtu se nuk ekziston mundësi për zbatimin e Aktvendimit të KMK-së Pa.nr. 10-73 i datës 26.05.2023. KMK e pranon këtë si arsye që e bën zbatimin e Aktvendimit të pamundur dhe e shpall aktvendimin si të PAVLEFSHËM.

Bazuar si më sipër, KMK vendosi siç është theksuar në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Udhëzim për mjet juridik: Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e një kontesti administrativ para gjykatës kompetente brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij. Padia nuk e pezullon zbatimin e aktvendimit.

KRYETAR

I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

Prof. Dr. Владимир Наумовски